



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 64 Datë 19.09.2007

PËR
MIRATIM FONDI PREJ 62.000 LEKE PËR KONCERTIN VOKAL
INSTRUMENTAL I ZNJ. TEUTA KOÇO

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës dhe Drejtoria e Financës për "PËR MIRATIM FONDI PREJ 62.000 LEKE PËR KONCERTIN VOKAL INSTRUMENTAL I ZNJ. TEUTA KOÇO". bazuar në ligjin nr. 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32, pika "dh", ligjin nr 8379 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal". Ligji nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007". Udhëzimin nr 2 dt 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2007". Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr 2 dt.02.02.2007 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007», mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 62.000 lekë për koncertin vokal instrumental të Znj. Teuta Koço.
2. Ky fond do të përballohet nga fondi i kursyer nga tenderi « Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007 » (fond i kursyer nga ruajtja e institucionit të Qendres Ekonomike të Kulturës)
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Sektori i Kulturës në Bashki dhe Qendra Ekonomike e Kulturës "Vangjush Mio".
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit
Raimonda NASE
Raimonda NASE